



USHTRIA



Viti i 76-të i botimit Nr. 30 (827834)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 28 korrik 2023

Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO

Pranë ambienteve të auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia e Diplomimit të oficerëve në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursin e Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, Ambasadori i Republikës së Kosovës z. Durmishi, Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës kolonel Hoti, komandantë forcash dhe të njëjve

autonome të FA-së, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, pedagogë, staf mbështetës etj. Në fjalën e mirëseardhjes, zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi vlerësoi angazhimin dhe seriozitetin e treguar, si nga ana e kursantëve, stafit akademik, dhe personelit mbështetës, duke treguar vlera dhe arritur rezultate të larta në përfundim të vitit akademik. Ai falënderoi Shtabin e Përgjithshëm të FA-së për mbështetjen konstante në zhvillimin normal të

aktiviteteve ekstrakurrikulare brenda dhe jashtë vendit. Në emër të kursantëve përshëndetën nënkolonel Dritor Papa, përfaqësues nga Forcat e Armatosura dhe nënkolonel Brahim Kokollari përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të cilët uruan kolegët për përfundimin me sukses të kursit. Nënkolonel Papa në fjalën e tij falënderuese në emër të kursantëve u shpreh se, gjatë këtij kursi iu kushtua një vëmendje e veçantë stërvitjeve komando-shtabi...

»» faqe 6



Ministri Peleshi: Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një 'laborator' të formimit të gjeneratës së re, të liderit të ardhshëm në nivel kombëtar



»» faqe 3

Ministri Peleshi: Bashkëpunim për menaxhimin e zjarreve, të gatshëm të ndërhyjmë sa herë që nevojitet

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi thirri në një takim prefektët, kryetarët e bashkive si dhe drejtues të strukturave operacionale të Mbrojtjes Civile, për të diskutuar në lidhje me masat për parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës. Në prani edhe të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji i, ministri Peleshi kërkoi koordinim më...



»» Faqe 2

SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim atashetë ushtarakë të Polonisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji priti atasheun ushtarak të Republikës së Polonisë, kolonel Tomasz Koperwas, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë. Gjatë takimit u prezantua atasheu i ri ushtarak i Polonisë që do të shërbejë në vendin tonë, kolonel Przemyslaw Balut. Gjeneralmajor Kingji vlerësoi nivelin shumë të lartë të bashkëpunimit ushtarak dypalësh...



»» Faqe 7

'Akademia e Forcave të Armatosura, garanci për të ardhmen e sigurt'

Akademia e Forcave të Armatosura ka dhënë një kontribut efektiv për të arsimuar, edukuar brezat e rinj si dhe për të trajnuar kuadrot oficerë dhe civilët e FA-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë, në të gjitha nivelet e komandimit e të drejtimit. Fokusi themelor i AFA-së është edukimi dhe kualifikimi i oficerëve dhe civilëve, i cili është domosdoshmëri për përgatitjen dhe zhvillimin inovativ të lidershipit ushtarak për të gjitha nivelet e drejtimit. AFA siguron dhe garanton edukim themelor të nevojshëm për profesionalizmin e oficerëve në të gjitha nivelet si dhe ekspozimin e ideve të reja në karrierën...



»» Faqe 4

Ministri Peleshi: Bashkëpunim për menaxhimin e zjarreve, të gatshëm të ndërhyjmë sa herë që nevojitet

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi thirri në një takim prefektët, kryetarët e bashkive si dhe drejtues të strukturave operacionale të Mbrojtjes Civile, për të diskutuar në lidhje me masat për parandalimin e zjarreve gjatë sezonit të verës.

Në prani edhe të drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingj i, ministri Peleshi kërkoi koordinim më të mirë të punës për përballimin e emergjencave në nivel vendor.

Peleshi tha se Ministria e Mbrojtjes dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile kanë kapacitete operacionale në dispozicion dhe janë të gatshëm të ndërhyjnë sa herë që nevojitet, por emergjencat si zjarret duhen sinjalizuar dhe ndalur që në fazën fillestare për të shmangur kalimin në përmasa më të mëdha.

“Ne nuk jemi një vend pa kapacitete operacionale. Kemi 1600 punonjës zjarrfikës në të gjithë vendin, 182 mjete zjarrfikëse, 80 autobote uji, kemi personelin dhe mjetet e FA-së, që siç e dini në çdo emergjencë janë në ballë të aksionit, të gjitha strukturat e policisë që janë në dispozicion dhe me të cilët punojnë shumë mirë, urgjencën shëndetësore, rrjetin e vullnetarëve, etj.”, - u shpreh z. Peleshi.

Sipas tij, që prej një viti Shqipëria ka edhe mbështetje shumë të madhe nga anëtarësimi me të drejta të plota në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile.

“Kjo do të thotë që nëse në të gjitha nivelet vendore e qendrore shterojnë burimet, ne kemi edhe një suport nga ky mekanizëm që na ka funksionuar dhe është një nga më eficientët. Teknologjia është shtuar. Kemi dronët për rikonjicionet, kemi dronët “Puma”, që janë vënë në punë nga viti i kaluar e që na japin informacion shumë të dobishëm dhe në kohë shumë të shpejtë. Gjithashtu edhe imazhet satelitore janë tani një ndihmë dhe një vlerë e shtuar”, - u shpreh Peleshi.

Sipas këtyre të dhënave satelitore, ministri Peleshi tha se janë evidentuar 125 vatra zjarri në muajt qershor-korrik, vatra të cilat janë menaxhuar shumë mirë nga njësitë vendore.

“Helikopteri është aty me shumë mjete zjarrfikëse, autobote uji dhe mjete të tjera gërmuese. Por duhet thënë që sa herë që ka një zjarr të madh, ka një lloj dështimi nga rrjeti i monitorimit dhe i sinjalizimit të hershëm. Nuk ka shans që nëse ky rrjet funksionon siç duhet, duke filluar nga kryepelqtë e fshatrave apo sensibilizimi i komuniteteve. Nëse njoftohet herët nuk ka mundësi që zjarri të marrë përmasa të mëdha”, -tha ministri Peleshi.

Gjithashtu ministri i Mbrojtjes Peleshi vlerësoi punën e bërë vitet e fundit sa i përket monitorimit, vëzhgimit dhe reagimit ndaj emergjencave, por shtoi se ka disa bashki apo rajone, kur kjo nuk funksionon.

“Kemi hyrë në një stinë shumë të nxehtë, më të nxehtë se ajo e vitit të kaluar, ajo e të nxehtit



afrikan që pritet të prekë pjesën e Shqipërisë jugore dhe asaj të mesme, por nuk përjashtohet asnjë territor. Kemi patur edhe shumë zona të freskëta malore ku ka patur zjarre vitin e kaluar. Pra, vigjilenca duhet të jetë kudo, duke filluar nga komunitetet. Mbani kontakte të përditshme me kryepelqtë e fshatrave, t'i trajtoni, t'i kërkoni të njoftojnë. Sinjalizimi i hershëm është çelësi. Nga eksperiencia, ku funksion siç duhet sistemi nuk ka zjarre të mëdha. Shmangin atë që është thelbi, humbjen e jetëve të njerëzve, sepse përmasat e emergjencës nuk mund të rriten nëse jemi në mënyrë kapilare në monitorim. Kemi parë që vende shumë më të fuqishme se ne, si Turqia, apo edhe së fundi Greqia përballesh me emergjencat shumë të forta, dëme të mëdha, në njerëz në pasuri. Pra, nuk është e lehtë, sado ta kesh flotën e helikopterëve apo zjarrfikësit, nuk mund të përballesh me emergjencat kur ato marrin përmasa të mëdha”, - theksoi Ministri i Mbrojtjes. Ai kërkoi gjithashtu nga drejtuesit vendorë të kenë gati edhe planet e evakuimeve.



Efektivët e Forcës Ajrore dhe helikopteri “Cougar” iu përgjigjën menjëherë kërkesës së autoriteteve vendore për të ndihmuar me ndërhyrje nga ajri për vënien në kontroll të flakëve në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu Forcat e Armatosura dhe Emergjencat Civile po punojnë edhe nga terreni për të frenuar përhapjen e zjarrit që favorizohet nga era dhe temperaturat e larta.





Ministri Peleshi: Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një 'laborator' të formimit të gjeneratës së re, të liderit të ardhshëm në nivel kombëtar

Në amfiteatrin pranë kodrave të Liqenit Artificial, u organizua ceremonia e diplomimit të 80 studentëve të Akademisë së Forcave të Armatosura, në të cilin morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, zëvendësministri i Arsimit, gjeneralë, drejtorë e familjarë.

“Sfidat me të cilat përballen FA-të, vendi dhe gjithë Aleanca, janë në evolucion të përhershëm, sikurse duhet të jetë edhe arsimiti ushtarak, mënyra se si do të përballohen sfidat. Këto sfida na rrisin ndjeshmërinë dhe përgjegjshmërinë për misionin dhe rolin e FA-së, përfaqshjen në adresimin e problemeve me të cilat përballemi, si dhe kërkesat e detyrat që duhet të përmbushë arsimiti ushtarak. Edukimi dhe trajnimi duhet të jetë komplementar e që shfrytëzon gjithë mundësitë që ofrojnë institucionet e ndryshme të FA-së dhe vetë forcat. Përveç institucioneve të arsimitit institucional, të cilat duhet të rrisin fleksibilitetin, përmirësojnë metodologjinë dhe përditësojnë programet edhe qendrat stërvitore të forcave dhe vetë njësitë e repartet, duhet të përmbushin rolin që u takon për transmetimin e vlerave profesionale dhe ruajtjen e zhvillimin e specialiteteve për të cilat ka nevojë FA”, - kështu do ta hapte fjalën e rastit komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigadë Bilbil Bitri në ditën e diplomimit të 80 oficerëve të rinj, mes të cilëve 52 studentë të brezit të parë të degës “Shkenca Ushtarake”, të cilët tashmë janë pjesë e Forcave të Armatosura.

“Klasa e vitit 2023 ju jeni gati të përballeni me sfidat që ju presin. Ju jeni gati të merrni përgjegjësi, Ju jeni gati për të drejtuar. Ju jeni edukuar për të jetuar me nder. Ju keni aftësitë të arrini majat. Paçi bekimin e Zotit në udhëtimin tuaj, në të ardhmen si oficerë!”, - do e mbyllte urimin e tij gjeneral brigadë Bilbil Bitri.

Një rrugëtim sfidues, dinjitoz, mision për të qenë aty ku e kërkon kombi, detyra.

Ndërsa ministri Peleshi, në fjalën e tij përshëndetëse vlerësoi rrugëtimin e këtyre të rinjve që zgjedhën edukimin ushtarak, një sfidë jo e lehtë, siç u shpreh ai, por një zgjedhje e mbështetur tek vlerat, patriotizmi dhe kombi.

“Shërbimi në Forcat e Armatosura është më shumë sesa një mision, ai është mishërimi i detyrës së vështirë, sakrificës por në të njëjtën kohë është sfida e të qenit i pari aty ku e kërkon kombi e detyra”, - theksoi në fjalën e tij ministri Peleshi.

Gjithashtu ministri Peleshi vlerësoi edhe punën që bëhet në Akademinë e FA-së për formimin e të rinjve që zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura: “Synojmë ta kthejmë këtë akademi në një ‘laborator’ të formimit të gjeneratës së re të oficerit të ri, liderit të ardhshëm më të mirë në nivel kombëtar”, - deklaroi ministri Peleshi.

Për vitin akademik 2023 - 2024 në këtë Akademi do të çelen programet bachelor në: “Marrëdhënie Ndërkombëtare në fushën e Mbrojtjes” dhe “Shkenca Komunikimi në fushën e Mbrojtjes”, programe, të cilat, sipas ministrit, mbështeten në komponentët e liderit, karakterit, ekselencës



akademike e përgatitjes së lartë fizike, model i huazuar nga eksperiencia 240 vjeçare amerikane, falë partneritetit me akademinë ushtarake të SHBA-së “West Point”. Më tej, gjatë fjalës së tij, ministri Peleshi tha se: “... si vend anëtar i NATO-s, këta oficerë do të mësojnë të drejtojnë ekupe efektive plotësisht të afta të mbështesin operacionet e përbashkëta dhe shumëkombëshe, në mesin e një ndryshimi teknologjik dhe organizativ të shpejtë e të vazhdueshëm”. Ministri i Mbrojtjes njoftoi se kanë nisur bashkëpunimet me Qendrën e Ekselencës Kibernetike në Estoni, ndërsa ka filluar në zbatim të ideve inovative në funksion të përmirësimit të kapaciteteve dhe standardeve, si dhe kushteve të punës e jetesës së djemve dhe vajzave në uniformë: “Sfidave që paraqet koha, por edhe falë profesionit tuaj të veçantë, qeveria shqiptare ka vendosur t’u përgjigjet nëpërmjet një vëmendjeje të shtuar, duke ofruar një paketë mbështetjeje komplekse që përfshin modernizimin, rritjen e pagave, trajtim financiar për vështirësitë

si dhe mbështetje me strehim për oficerët që shërbejnë larg qendrave të tyre të banimit”, - theksoi ministri Peleshi. Në fund, ai ftoi të rinjtë e të rejtat që të ndjekin rrugën e këtyre oficerëve të sapo diplomuar, t’u bashkohen Forcave të Armatosura.

Ministri i Mbrojtjes në fjalën e tij theksoi se kanë nisur bashkëpunimet me Qendrën e Ekselencës Kibernetike në Estoni, ndërkohë ka filluar edhe procesi për anëtarësimin e Qendrës së Ekselencës në Finlandë për kërcënimet hibride.

Duke folur për ngritjen e qendrës së Inovacionit teknologjik, pjesë e FA-së, ministri Peleshi tha se ajo do të shërbejë dhe vënien oficerëve të sapo diplomuar, t’u bashkohen Forcave të Armatosura, për t’i shërbyer një realiteti të ri, më të mirë pajisur, më të mirë trajnuar dhe më të mirë arsimuar. Pjesë e oficerëve të rinj që sapo morën këtë titull janë edhe 52 studentët e brezit të parë të degës “Shkenca Ushtarake”, ndërsa 28 janë të “Kursit të Oficerit të Ri. Mes tyre titullin “oficer” e morën edhe 21 vajza.



'Akademia e Forcave të Armatosura, garanci për të ardhmen e sigurt'



INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Akademia e Forcave të Armatosura ka dhënë një kontribut efektiv për të arsimuar, edukuar brezat e rinj si dhe për të trajnuar kuadrot oficerë dhe civilët e FA-së dhe institucioneve të tjera të sigurisë, në të gjitha nivelet e komandimit e të drejtimit.

Fokusi themelor i AFA-së është edukimi dhe kualifikimi i oficerëve dhe civilëve, i cili është domosdoshmëri për përgatitjen dhe zhvillimin inovativ të liderit ushtarak për të gjitha nivelet e drejtimit.

AFA siguron dhe garanton edukim themelor të nevojshëm për profesionalizmin e oficerëve në të gjitha nivelet si dhe ekspozimin e ideve të reja në karrierën ushtarake.

Me kurset dhe programet e ofruara nga AFA, sigurohet edukimi dhe trajnimi i oficerëve të FA-së si dhe investohet për përgatitjen dhe zhvillimin e tyre në të gjitha nivelet e drejtimit. Koncepti i edukimit dhe arsimimit në AFA fokusohet në detyrimet që shtrohen përpara një force anëtare të NATO-s, në kërkesat aktuale dhe të së ardhmes të FA-së, zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit arsimor ushtarak, për ta bërë atë sa më cilësor e fleksibël, në funksion të zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë si dhe në përgatitjen për t'iu përgjigjur sfidave, realiteteve dhe mundësive të reja në kushtet e një mjedisi të ri të sigurisë.

Objekti parësor i AFA-së është mbështetja me burime njerëzore të mirë arsimuara, aftësi profesionale të personelit të FA-së në funksion të rritjes së kapaciteteve operacionale në interes të realizimit të misionit, si dhe kontribuimit në zgjidhjet e çështjeve të sigurisë dhe mbrojtjes në rrafshin kombëtar, rajonal dhe të Aleancës Euroatlantike. AFA, ka shkruar histori suksesi, pasi ajo ka përgatitur dhe vazhdon të përgatisë me dhjetëra LIDERË, siç janë dhe 80 studentët e ciklit Bachelor, të cilët diplomohen sot për të ecur përkrah profesorëve të tyre me dinjitet dhe përkushtimi ashtu siç është dhe motoja e tyre "Atdheu, Nderi, Detyra".

Në emocionet e kësaj dite të bukur të diplomimit, për gazetën 'Ushtria' ne mundëm t'i marrim një intervistë njërit prej studentëve, i cili na përçollti momente të këtyre tre viteve studimi si dhe mirënjohjen për liderin politik por dhe ushtarakë të cilët i kanë dhënë vëmendjen maksimale arsimimit dhe kushteve të jetesës brenda ambienteve të garnizonit.

Si quheni?

Quhem Pashk Preçi, 23 vjeç, kam lindur në Mirditë, banoj në Lezhë. Shkollën 9-vjeçare e kam përfunduar në Lezhë, ndërsa kam kryer



shkollën e mesme profesionale në Shkodër, në degën Elektroteknikë. Pasi përfundova shkollën e mesme nuk isha i vendosur në lidhje me arsimin e lartë, se ku do ta kryeja, këtu në Shqipëri apo jashtë saj.

Pse keni zgjedhur pikërisht të studioni pranë Akademisë së Forcave të Armatosura?

Kisha një eksperiencë jashtë Shqipërisë për një periudhë 3-mujore, por nuk u gjenda mirë, ndaj vendosa të kthehesha sërish në Shqipëri.

Përveç shërbimit të detyrueshëm ushtarak, asnjë nga familjarët e mi nuk ka pasur një eksperiencë në Forcat e Armatosura. Kur isha duke kërkuar një orientim për arsimimin e lartë, sapo ishte hapur opsioni i studimit në shkenca ushtarake, ishte brezi i parë. Të jem i sinqertë, në fillim e zgjedha si alternative për të plotësuar dhjetë degët me zgjedhje që duhet të vendosja në formularin e aplikimit për shkollën e lartë. Kur pashë që isha kualifikuar, e pranova menjëherë

dhe fillova të hulumtoja në internet për të marrë informacion rreth Forcave të Armatosura. Ishte më shumë forca e kuriozitetit, sepse ishte diçka krejt e panjohur për mua, e panjohur edhe nga rrethi shoqëror, pasi ishte brezi i parë që hapte këtë akademi, pas shumë vitesh ndërprerje. Së dyti ishte dëshira për të investuar tek e ardhmja ime, në përmirësimin e në forcimin e karakterit, në formimin e përgjithshëm, sepse FA-të kanë impakt të madh në jetën civile, siç thuhet nga anëtarë tona: "ushtria të burrëron". Pra, mendova se ky ishte investimi më i mirë për veten.

Ishte një zgjedhje e dëshiruar nga ju?

Po, ishte zgjedhja ime. Dhe nuk jam zhgënjyer. Kur erdha në ambientet e garnizonit 'Skënderbej' u përballa me rregullin dhe disiplinën aq të rëndësishme për të gjithë, e cila na bën qytetarë me edukatë europiane, pjesë e së cilës presim dita-ditës të aderojmë.

Çfarë mendoni se do të sjellë për ju ky profesion?

Të qenit në uniformën ushtarake, është një përvojë e madhe mjaft sfiduese. Aktivitetet e studentëve nuk kanë të ndalur, mundësitë për të zhvilluar veten në sferën që ka përcaktuar një student janë të shumta. E rëndësishme është vetëm sa njeriu të arrijë ta menaxhojë kohën në mënyrë sa më racionale. Një tjetër përparësi që të jep studimi në këtë akademi janë mundësitë për t'u njohur me njerëz profesionistë që të ndihmojnë në çdo hap, krijimi i lidhjeve me njerëz që kanë vizione të mëdha për të ardhmen dhe bashkëpunimi me ta. Ajo që kam mësuar gjatë viteve të studimit është pavarësia, pjekuria dhe formësimi i një karakteri, ku gjërat i sheh me një sy kujdesi të ç' do detaji.

Çfarë e motivon një ushtarak?

Nuk ka rëndësi sa fuqi, brilancë ose energji kemi, nëse nuk e shfrytëzojmë atë dhe nuk fokusohemi në një objektiv specifik, nuk do arrijmë të përmbushim asnjëherë synimet tona.

Prandaj ajo që më motivon mua si oficer janë: Nevoja për të ecur përpara, për të arritur marrëdhënie dhe vendosur standarde apo për të arritur suksese.

Nevoja për t'i bërë të tjerët të sillen në një





mënyrë që ata s'do të kishin mundur të silleshin ndryshe.

Dëshira për kontakte miqësore dhe të afërta personale. Dëshira për t'u pëlqyer dhe pranuar nga të tjerët. Preferenca për marrëdhënie bashkëpunuese sesa marrëdhënie konkurruese dhe dëshirë për marrëdhënie të cilat përfshijnë një gradë të lartë mirëkuptimi. Është e rëndësishme të mos të ngatërrojmë këto nevoja të ndryshme. Nevoja për rezultate nuk është domosdoshmërisht një fakt për të krijuar drejtues të mirë, mbase ata mund të jenë më të interesuar në performancën personale sesa në influencimin e të tjerëve.

Pas një cikli trevjeçar, ju patjetër keni dhe përshtypjet tuaja për pedagogët tuaj, marrëdhëniet me ta, si dhe mësimdhënien në auditorët e fakultetit. Me çfarë përshtypjesh largoheni prej tyre?

Mësimdhënia ka qenë shumë profesionale, për arsye se pedagogët janë ekspertë që ushtrojnë profesionin e tyre në fushën e tyre, dhe më mirë se eksperiencia e tyre nuk mund të jetë asnjë mësim, asnjë leksion, asnjë doktrinë. Gjithashtu pjesë e programit kanë qenë edhe degë shumë të largëta për ne, si civilë të sapo dalë nga gjimnazi, si për shembull Marrëdhënie Ndërkombëtare, janë degë të cilat janë mjaft të reja e të panjohura dhe të vështira për ne, por që janë tepër interesante dhe të bëjnë për vete, sepse janë gjëra të reja që si kemi hasur më parë.

Të gjithë pedagogët janë të mirë e të vlerësuar njësoj për ne, sepse secili prej tyre ka treguar profesionalizëm dhe vlera njerëzore aq shumë të rëndësishme për ne në këtë rrugëtim të ri.

Por këtu dua të falënderoj gjithë katedrën për përkushtimin dhe përgjegjësinë ndaj nesh.

Cilat janë pritshmëritë tuaja në të ardhmen?

Si fillim duhet të qetësohemi e të falënderojmë veten, që ia arritëm ta mbyllim me sukses, sepse ka qenë një rrugëtim mjaft i vështirë dhe duhet të vlerësojmë punën e mundimet që kemi kaluar për t'ia arritur kësaj dite. Pas kësaj do ndjekim rrjedhën e procesit, i cili do të vendosë vijimin e rrugëtimin tonë, pasi është pjesë e punës. Ne jemi pyetur se ku preferojmë të shërbejmë, nuk e di sa do merret parasysh, por duke qenë se unë jam ende i paqartë me veten se ku ekzaktësisht dua të jem, ia lë procesit në dorë dhe jam i bindur se kudo që të jetë, unë do të bëj më të mirën dhe me shumë mundësi do ia dal.

Një pjesë e mirë e studentëve zgjedhin të shkojnë jashtë në përfundim të studimeve. Po ju a e keni menduar ndonjëherë të largoheni?

Logjikisht, kur ke punuar dhe arrin moshën 30-vjeçare në një profesion të caktuar, ke arritur të krijosh edhe një rreth shoqëror, sepse përtej punës me të njëjtët njerëz ke krijuar edhe marrëdhëniet shoqërore, do të ishte pamundur të shkëputesh e të fillosh nga e para. Kështu që unë jam i bindur që, nëse fundi i kësaj kontrate më arrin në profesionin e ushtarakut, jam i sigurt që e do e vazhdoj deri në fund.

Dua që rrobën ushtarake ta mbaj me nder dhe dinjitet si një detyrë ndaj Atdheut të cilit i kemi borxh dhe jetën.

Të gjithë të rinjve dhe të rejave shqiptarë u bëj thirrje 'të nxënë' dije pranë Akademisë së Forcave të Armatosura sepse është garanci për të ardhmen e sigurt.



Diplomohen kursantët e KKSHP dhe KLO

Pranë ambienteve të auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, u zhvillua ceremonia e Diplomimit të oficerëve në Kursin e Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm dhe Kursin e Lartë të Oficerit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Në këtë aktivitet morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, Ambasadori i Republikës së Kosovës z. Durmishi, Atasheu Ushtarak i Republikës së Kosovës kolonel Hoti, komandantë forcash dhe të njëjve autonome të FA-së, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, pedagogë, staf mbështetës etj.

Në fjalën e mirëseardhjes, zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi vlerësoi angazhimin dhe seriozitetin e treguar, si nga ana e kursantëve, stafit akademik, dhe personelit mbështetës, duke treguar vlera dhe arritur rezultate të larta në përfundim të vitit akademik. Ai falënderoi Shtabin e Përgjithshëm të FA-së për mbështetjen konstante në zhvillimin normal të aktiviteteve ekstrakurrikulare brenda dhe jashtë vendit.

Në emër të kursantëve përshëndetën nënkolonel Dritor Papa, përfaqësues nga Forcat e Armatosura dhe nënkolonel Brahim Kokollari përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, të cilët uruan kolegët për përfundimin me sukses të kursit. Nënkolonel Papa në fjalën e tij falënderuese në emër të kursantëve u shpreh se, gjatë këtij kursi iu kushtua një vëmendje e veçantë stërvitjeve komando-shtabi, ku kursantët aftësohen në role apo funksione të ndryshme në Shtab, në zbatim të skenarëve të përgatitur me kujdes nga stafi pedagogjik i Kolegjit. “Në ndryshim nga vitet e tjera, këtë vit disa prej kursantëve patën



mundësi që njohuritë e marra gjatë procesit mësimor t'i vënë në zbatim në funksione të ndryshme në Shtabin e Task-Force SFAB, në kuadrin e stërvitjes “Defender Europe 23”, duke kontribuar në përmbushjen me sukses të misionit të kësaj task-force. Falë

punës së palodhur të stafit pedagogjik dhe mbështetjes së këtij kolegji, sot ndihemi më të aftë për të përballuar sfidat e sigurisë dhe në pjesëmarrjen në operacione si brenda dhe jashtë vendit”.
Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji, në fjalën

e tij përshëndetëse, iu uroi suksese në karrierën e tyre kursantëve dhe njëkohësisht, duke falënderuar stafin pedagogjik për punën e përkushtimit e jashtëzakonshëm gjatë procesit të zhvillimit të këtyre dy kurseve të shumë të rëndësishme, KKSHP dhe

KLO, u shpreh se: “Konstatoj me kënaqësi se i gjithë stafi drejtues dhe pedagogjik kanë bërë një punë jashtëzakonshme në procesin e konsolidimit të mëtejshëm të kolegjit, duke ofruar cilësi, standarde dhe seriozitet në mësimdhënie. Gjeneralmajor Kingji vlerësoi përkushtimin dhe performancën e kursantëve të KLO-së dhe KKSHP-së, në përfundimin me sukses të studimeve. Në përfundim të fjalës së tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Kingji falënderoi veçanërisht kursantët e FSK-së, dhe u uroi suksese në detyrat e reja.

Programet e këtyre dy kurseve siguruan dhënien e njohurive të nevojshme për planëzimin dhe drejtimin e operacioneve luftarake në një mjedis operacional kompleks dhe të paqartë që lidhet me sigurinë kombëtare, aftësimin për të marrë vendime të drejta dhe për të dhënë këshilla të sakta në rastet kur shqyrtohet përdorimit të forcës ushtarake.

Në këtë ceremoni u diplomuan 43 kursantë të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSHP) dhe 18 të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO) me pjesëmarrje nga strukturat e Forcave të Armatosura të RSH dhe nga Forca e Sigurisë së Kosovës. Ceremonia u mbyll me foto të përbashkët dhe shpërndarjen e diplomave.



KFT zhvillon konferencën koordinuese të stërvitjes “Strong Balkan 23”

Në ambientet e KFT-së u zhvillua konferenca përfundimtare koordinuese e stërvitjes së koduar “Strong Balkan 23”.

Qëllimi i konferencës ishte koordinimi përfundimtar i pikave të planëzimit të stërvitjes. Në konferencë morën pjesë efektivë nga Shqipëria, Bosnja, Bullgaria

Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Rumania dhe Turqia.

Në përfundim të konferencës, komandanti i FT-së, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia mbajti fjalën përshëndetëse.



Njësia Mjekësore e Forcave të Armatosura, në shërbim të komunitetit

Mjekët dhe infermierët e Njesisë Mjekësore të Forcave të Armatosura i janë bashkuar në 4 qytete: Tiranë, Shkodër, Gjirokastrë e Berat, planit të masave të marra nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kundër valës së të nxehtit.

Mirënjohje efektivëve tanë që në këto ditë me temperatura përvëluese janë pranë qytetarëve me njësitë e lëvizshme!

Bëni kujdes dhe respektoni këshillat e specialistëve.



SHSHPFA, gjeneralmajor Arben Kingji priti në takim atashetë ushtarakë të Polonisë

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji priti atashen ushtarak të Republikës së Polonisë, kolonel Tomasz Koperwas, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë. Gjatë takimit u prezantua atashen i ri ushtarak i Polonisë që do të shërbejë në vendin tonë, kolonel Przemyslaw Balut.

Gjeneralmajor Kingji vlerësoi nivelin shumë të lartë të bashkëpunimit ushtarak dypalësh ndërmjet Shqipërisë dhe Polonisë, si dhe siguroi për mbështetjen dhe vijimësinë e projekteve të bashkëpunimit edhe në të ardhmen.

Gjeneralmajor Kingji në përfundim të takimit i paraqiti kolonel Tomasz Koperwas “Medaljen e Mirënjohjes”, akorduar nga ministri i Mbrojtjes.



“USS Ramage” (DDG 61), destroyer i raketave të komanduara i klasit “Arleigh Burke”, zhvilloi një vizitë në portin e Durrësit

Destrojer (shkarkuesi) i raketave të komanduara i klasit “Arleigh Burke” USS Ramage (DDG 61), pjesë e “Carrier Strike Group” (CSG) 12, Gerald R. Ford CSG, mbërriti në Durrës këtë javë për një vizitë portuale të planifikuar.

Vizita në port ofron mundësinë për të përmirësuar partneritetin ndërmjet SHBA-ve dhe Shqipërisë në mbrojtje dhe ndërveprimin tonë të vazhdueshëm si aleatë në NATO.

Komandanti i “USS Ramage” Tim Yuhas përshëndeti homologët e tij të Marinës shqiptare dhe vuri në dukje se marrëdhënia me Shqipërinë është ndërtuar mbi një themel të vlerave, përvojave dhe vizionit të përbashkët.



Zhvillohet stërvitja “Antindotja 2023”

Në rajonin e gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja “Antindotja - 2023”, e cila është një nga aktivitetet kryesore të Forcës Detare. Kjo stërvitje u zhvillua në bashkëpunim edhe me Institucionin e Prefektit të Qarkut Vlorë, Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, “La Petrolifera Italo - Albanese”, Agjencinë Rajonale të Mjedisit, Kapitanerinë e Portit Detar, Vlorë.

Stërvitja kishte si qëllim trajnimin, stërvitjen e efektivave të anijeve (kryesisht të anijes speciale antindotje) për përdorimin e pajisjeve, mekanizmave, mjeteve dhe teknikave të reagimit ndaj ndotjeve detare. Gjithashtu fokusi i kësaj stërvitje ishte përmirësimi i koordinimit midis institucioneve me interesa në det, në përgjigje të emergjencave civile, ndaj ndotjeve detare si dhe testimi i kapaciteteve reaguese të Flotiljes Detare.

Në stërvitje morën pjesë tre anije të Flotiljes Detare: anija speciale antindotje “Karaburuni Y-32”, “Rodoni” Y-31 dhe anija “Oriku” P-132, si edhe një gomone e anijes së klasit “Iliria” P-132. Stërvitja u ndoq dhe vlerësua nga Shtabi i Flotiljes Detare nën drejtimin e komandantit të Flotiljes Detare



Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj. Gjatë zhvillimit të “DVD” të stërvitjes “Antindotja 2023” morën pjesë prefekti i Qarkut Vlorë, zoti Flamur Mamaj, përfaqësues të “La Petrolifera Italo-Albanese”, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare, Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, Agjencisë Rajonale të Bregdetit, Portit Detar Vlorë dhe përfaqësues të Shtabit të Forcës Detare. Prefekti i qarkut Vlorë, zoti Flamur Mamaj në fjalën përshëndetëse falënderoi Forcën Detare

dhe Flotiljen Detare për organizimin dhe zhvillimin e stërvitjes, gjithashtu kërkoi nga të gjitha institucionet pjesëmarrëse angazhim maksimal dhe realizimin me përgjegjësi të detyrave në bazë të ligjit në rastin e një emergjence apo ndotjeve detare. Në përfundim të stërvitjes, komandanti i Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut I Engjëll Sinanaj falënderoi efektivat për përgatitjen, angazhimin dhe profesionalizmin e treguar gjatë zhvillimit të stërvitjes si dhe falënderoi përfaqësuesit e strukturave pjesëmarrëse në këtë aktivitet.

Armë shqiptare të shek. XVII-XIX

Koburet serme punoheshin nga armëtarët dhe argjendarët shkodranë. Dorezën e kishin si kokë gjarpri, të veshur me pafta argjendi...


Si nga ana funksionale, ashtu edhe nga paraqitja e jashtme prodhimi i armëve tregonte për një nivel të lartë tekniko-mjeshtëror të arritur në vendin tonë.

Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali.

Këto armë janë pisqolla dhe shpata shqiptare e Marko Boçarit në Muzeun e Armëve ne Paris. Koburja e përdorur nga Marko Boçari është e tipit gjarpërushe e zbukuruar me argjend, ndërsa shpata është e llojit sabre që përdorej nga kavaleritë europiane të kohës. Koburet serme punoheshin nga armëtarët dhe argjendarët shkodranë. Dorezën e kishin si kokë gjarpri, të veshur me pafta argjendi. Ato qenë skalitur me motive bimore të stilizuara, në relief. Tyta dhe çarku bëheshin prej hekuri. Gjatësia e tyre arrinte rreth 59 cm, ndërsa kalibri 20 mm. Koburet serme qenë prodhim i viteve 1780-1800. Ato janë përdorur si armë brezi nga suljotët.

Shpata e llojit sabre është një shpatë e kavalerisë së lehtë e përdorur në luftërat e Napolonit në Europë. Ajo përbëhej nga një dorezë që mbronte dorën, një teh të gjatë më dy presa dhe në fund me një përthyerje të fortë. Marko Boçari ka të ngjarë ta ketë përfutuar në kohën kur shërbente në Ishujt Jonianë në regjimentin shqiptar "Gjuajtësit e Orientit" të formuar nga francezët e të përbërë nga shqiptarë.

Regjimenti "Gjuajtësit e Orientit" ishte një regjiment i formuar kryesisht nga suljotët dhe nga shqiptarët e tjerë nga kontinenti që



huaj e gjejmë të emërtuar thjesht "amautka" apo "paftalia". Kjo armë, në fakt, ka qenë përmirësimi i mëtejshëm i pushkës me fitil, i mushkëtës dhe i arkebuzit, të përdorura në vendin tonë gjatë shek.

XV-XVII. Me spikatjen e çarkut me goditje dhe gur stralli, rreth vitit 1630, pushka e gjatë filloi dhe vazhdoi të prodhohej nga armëtarët shqiptarë gjatë shek. XVII-XIX.

Ka të dhëna se Shkodra, si qendër e madhe tregtare dhe zejtare, qendër sanxhaku, vilajeti dhe pashallëku, me tytat e vendit dhe të jashtme, plotësonte jo vetëm nevojat e veta, por me to furnizonte edhe Prizrenin, Gjakovën, Tetovën, Elbasanin, madje ato shiteshin në Delvinë, në Grabovën e Gramshit deri në Bonila të Janinës.

Si nga ana funksionale, ashtu edhe nga paraqitja e jashtme prodhimi i armëve tregonte për një nivel të lartë tekniko-mjeshtëror të arritur në vendin tonë. Shqiptarët e Shkodrës,

të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali. Në Ekspozitën Universale të Parisit (1854), nga objektet që tërhoqën vëmendjen e vizitorëve të huaj ishin edhe koburet shqiptare të Janinës.

Në konkursin e Londrës (1866) po këto armë morën tituj nderi. Në Ekspozitën Universale të Parisit (1867) figuronin armë dhe disa punime filigrani të prodhuara nga punishtet e Prizrenit, të cilat nuk qëndronin më poshtë nga ato të punonjësve më të kualifikuar të Evropës.

Ndërsa në Ekspozitën Universale të Cikagos (1894) ishte vendosur edhe një martinë e punuar me mjeshtëri të hollë nga dora e një armëtari të talentuar nga Tetova.



ofronin shërbimin tradicional të mercenarisë por edhe kishin braktisur vendet e tyre si rezultat i armiqësisë që kishin pasur me pushtetin e centralizuar të Ali Pashë Tepelenës.

Në armatimin personal, qoftë të ushtarit të ushtrive feudale shqiptare, apo të çdo banori të armatosur, në shek. XVII-XIX, bënin pjesë: pushka e gjatë (karajfilja) ose pushka e shkurtër (karabina), dy pistoleta (kobure), jatagani, dy vezme, vaj-mbajtësja, thupra (harbia) dhe brezi i mbajtjes së armëve (silahu). Pushka e gjatë shqiptare, e cila prodhohej e zbukurohej edhe në vend, të cilën tek shumë autorë të tjerë të

◉ ***Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali.***



PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Këshilli NATO-Ukrainë trajton situatën e rëndë të sigurisë në Detin e Zi

Aleanca e gatshme të mbrojë çdo centimetër të territorit të saj, çdo agresion



Këshilli NATO-Ukrainë u mbledh, më 26 korrik 2023, për të trajtuar situatën serioze të sigurisë në rajonin e Detit të Zi pas përfundimit të njëanshëm nga Rusia të Iniciativës së Grurit të Detit të Zi, të ndërmjetësuar nga Kombet e Bashkuara dhe Turqia. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg thirrri takimin pas kërkesës për konsultim për krizën nga Presidenti Volodymyr Zelenskyy. Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană kryesoi Këshillin. Aleatët dhe Ukraina dënuan me forcë vendimin e Rosisë për t'u tërhequr nga marrëveshja e grurit të Detit të Zi dhe përpjekjet e saj të qëllimshme për të ndaluar eksportet bujqësore të Ukrainës nga të cilat varen qindra miliona njerëz në mbarë botën. Ata dënuan gjithashtu sulmet e fundit me raketa të Rosisë në Odesa, Mykolaiv dhe qytete të tjera portuale, përfshirë sulmin cinik me dron të Moskës në objektin e magazinimit të grurit të Ukrainës në qytetin port të Danubit, Reni, shumë afër kufirit rumun. Aleatët vunë në dukje se zona e re paralajmëruese e Rosisë në Detin e Zi, brenda zonës ekskluzive ekonomike të Bullgarisë, ka krijuar rreziqe të reja për llogaritje të gabuara dhe përshkallëzime, si dhe pengesa serioze për lirinë e lundrimit.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană tha se "Rusia vazhdon të tregojë mungesë respekti të plotë për ligjin ndërkombëtar dhe për njerëzit në mbarë botën që varen nga gruri ukrainas. Rusia po kërcënon anijet civile, po terrorizon qytetet paqësore dhe po shkatërron pjesë të trashëgimisë kulturore botërore me sulmet e saj brutale. NATO është e bashkuar. Ne qëndrojmë në solidaritet me aleatët tanë të Detit të Zi, do të vazhdojmë të mbrojmë njëri-tjetrin dhe do të vazhdojmë të mbështesim Ukrainën për aq kohë sa të duhet".

Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg tha se: "Rusia mban përgjegjësinë e plotë për veprimet e saj të rrezikshme dhe përshkallëzuese në rajonin e Detit të Zi. Rusia duhet të ndalojë përdorimin e urisë si armë dhe të kërcënojë njerëzit më të cenusur në botë me paqëndrueshmëri ushqimore. Veprimet e Rosisë paraqesin gjithashtu rreziqe thelbësore për stabilitetin e rajonit të Detit të Zi, i cili është me rëndësi strategjike për NATO-n. Aleatët po rrisin mbështetjen për Ukrainën dhe po rrisin vigjilencën tonë. Ne mbetemi të gatshëm për të mbrojtur çdo centimetër të territorit aleat nga çdo agresion."

Aleatët mirëpritën përpjekjet e vazhdueshme të Turqisë për të rigjallëruar marrëveshjen e grurit, dhe përpjekjet e aleatëve të tjerë, përfshirë Bullgarinë dhe Rumaninë, si dhe Bashkimin Evropian dhe Kombet e Bashkuara për të mundësuar eksportin e vazhdueshëm të grurit ukrainas nga toka dhe deti. Aleatët gjithashtu e bënë të qartë se do të vazhdojnë t'i ofrojnë Ukrainës ndihmë të madhe ushtarake, ekonomike dhe humanitare.

NATO dhe aleatët po rritin mbikëqyrjen dhe zbulimin në rajonin e Detit të Zi, duke përfshirë avionët e patrullimit detar dhe dronët. Që nga viti i kaluar, në përgjigje të luftës së agresionit të Rosisë kundër Ukrainës, NATO ka rritur ndjeshëm praninë e saj në rajon, duke përfshirë dy grupe të reja beteje shumëkombëshe në Bullgari dhe Rumani.

26 korriku 2023, shënoi takimin e dytë të Këshillit NATO-Ukrainë, pas takimit të tij inaugurues në Samitin e Vilniusit në fillim të korrikut. Ambasadorëve të NATO-s dhe Suedisë së ftuar u bashkua me videokonferencë Oleksandr Kubrakov, zëvendësryeministër dhe ministër i Ukrainës për Komunitetet, Territorët dhe Infrastruktura dhe gjeneral brigade Oleksii Hromov, Zëvendës Shef i Drejtorisë kryesore Operative (J3) të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Rusia, kërcënimi i drejtpërdrejtë, prania ushtarake e NATO-s në lindje të Aleancës

Një komponent i rëndësishëm i qëndrimit parandalues dhe mbrojtës të NATO-s është prania ushtarake në pjesën lindore të territorit të Aleancës. Në vitet e fundit, aleatët kanë rritur praninë përpara të NATO-s duke krijuar grupe luftarake shumëkombëshe në Bullgari, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumani dhe Sllovakia. Ata gjithashtu kanë dërguar më shumë anije, aeroplanë dhe trupa në krahun lindor të NATO-s, nga Deti Baltik në veri deri në Detin e Zi në jug. Këto veprime demonstronin solidaritetin, vendosmërinë dhe aftësinë e aleatëve për të mbrojtur territorin dhe popullsinë e Aleancës.

Prania ushtarake e NATO-s në pjesën lindore të Aleancës është një pjesë kyçe e qëndrimit të forcuar të parandalimit dhe mbrojtjes së saj, e cila është përmirësuar vitet e fundit për të pasqyruar realitetin e ri të sigurisë në zonën euro-atlantike. Aneksimi i ilegallë të paligjshëm i Krimesë nga Rusia në 2014 dhe pushtimi në shkallë të plotë i Ukrainës në 2022 kanë ndryshuar rrënjësisht mjedisin e sigurisë në Evropë dhe NATO është përgjigjur duke forcuar ndjeshëm gatishmërinë e saj për të siguruar dhe mbrojtur të gjithë aleatët. Prania përpara e forcave aleate është mbrojtëse, proporcionale, transparente dhe në përputhje me angazhimet dhe detyrimet ndërkombëtare të Aleancës. Ajo përfaqëson një angazhim të rëndësishëm nga aleatët dhe është një kujtesë e prekshe se një sulm ndaj një aleati të NATO-s është një sulm ndaj të gjithëve.

eFP e NATO-s përbëhet nga tetë grupe beteje shumëkombëshe, të ofruara nga kombet kornizë dhe aleatët e tjerë kontribuues mbi një bazë vullnetare, plotësisht të qëndrueshme dhe rrotulluese. Grupet e betejes veprojnë në bashkëpunim me forcat kombëtare të mbrojtjes së brendshme dhe janë të pranishme gjatë gjithë kohës në vendet pritëse. Të tetë grupet e betejes janë formacione plotësisht të afta luftarake.

Grupet e betejes nuk janë identike; madhësia dhe përbërja e tyre u përshtaten faktorëve dhe kërcënimeve specifike gjeografike. Në përgjithësi, kërkesat ushtarake drejtojnë përbërjen e çdo grupi beteje.

Sot, trupat dhe personeli nga të gjithë aleatët shërbejnë, stërviten dhe ushtrohen së bashku, duke përfaqësuar një shprehje të fortë të unitetit dhe solidaritetit të Aleancës. Forcat nga kombet kontribuuese rrotullohen brenda dhe jashtë grupeve të betejes; në çdo kohë të

caktuar, ata mund të vendosen në grupet e betejes ose të stacionohen në vendet e tyre të origjinës me aftësinë për t'u vendosur me shpejtësi, nëse është e nevojshme.

Përbërja e tetë grupeve të betejes që nga qershori 2023

Tetë grupet e betejes janë integruar në strukturën komanduese të NATO-s për të siguruar gatishmërinë dhe reagimin e nevojshëm. Që nga qershori 2023, tetë grupet e betejes përbëhen nga aleatët e si më poshtë:

Vendi pritës: Bullgaria; Kombi kornizë: Italia; Kombet kontribuuese: Shqipëria, Greqia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara;

Vendi pritës: Estonia; Kombi kornizë: Mbretëria e Bashkuar; Kombet kontribuuese: Danimarka, Franca dhe Islanda;

Vendi pritës: Hungaria; Kombi kornizë: Hungaria; Kombet kontribuuese: Kroacia, Italia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara;

Vendi pritës: Letonia; Kombi kornizë: Kanada; Vendet kontribuuese: Shqipëria, Çekia, Danimarka, Islanda, Italia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Polonia, Sllovakia, Sllovenia dhe Spanja;

Vendi pritës: Lituania; Kombi kornizë: Gjermania; Kombet kontribuuese: Belgjika, Kroacia, Çekia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Portugalia dhe Shtetet e Bashkuara;

Vendi pritës: Polonia; Kombi i kornizë: Shtetet e Bashkuara; Kombet kontribuuese: Kroacia, Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar;

Vendi pritës: Rumania; Kombi kornizë: Franca; Kombet kontribuuese: Belgjika, Luksemburgu, Holanda, Maqedonia e Veriut, Polonia, Portugalia dhe Shtetet e Bashkuara;

Vendi pritës: Sllovakia; Kombi kornizë: Çekia; Kombet kontribuuese: Gjermania, Sllovenia dhe Shtetet e Bashkuara.

Grupet e betejes veprojnë në bashkëpunim me forcat kombëtare. Katër grupet e betejes verilindore (në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni) janë nën komandën e NATO-s përmes Shtabit të Korpusit Shumëkombësh Verilindor në Szczecin, Poloni. Dy shtabë të nivelit të divizionit koordinojnë aktivitetet stërvitore dhe përgatitore të grupeve të tyre të betejes përkatëse. Shtabi i Divizionit Shumëkombësh Verilindor i vendosur në Elblag, Poloni, ka qenë plotësisht funksional që nga dhjetori 2018. Ky shtab punon ngushtë me grupet e betejes në Poloni dhe Lituani. Shtabi plotësues i Divizionit Shumëkombësh të Veriut u aktivizua nga NATO në tetor 2020 dhe po shkon drejt aftësisë së plotë operationale. Elementet e tij përpara ndodhen në Adazi të Letonisë, ndërsa pjesa tjetër e selisë në Karup të Danimarkës. Ky shtab bashkëpunon ngushtë me grupet e betejes në Estoni dhe Letoni.

Shtabet e fokusuar në rajon, të tilla si selia qendrore e divizionit shumëkombësh në Székesfehérvár, Hungari, dhe selia e Divizionit Shumëkombësh Juglindor në Bukuresht, Rumani, kontribuojnë në funksionimin e katër grupeve luftarake juglindore (në Bullgari, Hungari, Rumani dhe Sllovakia).

Përveç kësaj, shumë aktivitete të ndërmarra nga Aleatët në nivel kombëtar, megjithëse nuk janë formalisht pjesë e pranisë përpara të NATO-s, gjithashtu kontribuojnë në rritjen e aktivitetit aleat në pjesën lindore të Aleancës.

Përforcim i shpejtë nëse është e nevojshme

Strategjia e përforcimit të shpejtë të NATO-s siguron që forcat e pranisë përpara do të përforcohen nga Task Forca e Përbashkët e Gatishmërisë Shumë të Lartë të NATO-s (VJTF), Forca më e gjerë e Reagimit të NATO-s, forcat shtesë të gatishmërisë së lartë të Aleatëve dhe forcat më të rënda përcjellëse të NATO-s, nëse është e nevojshme.

Në Samitin e NATO-s të vitit 2022 në Madrid, aleatët ranë dakord për një model të ri të forcës së NATO-s, i cili përfaqëson një zgjerim më të gjerë të forcave të gatishmërisë së lartë potencialisht të disponueshme për NATO-n, ku dhe kur kërkohet. Ndërkohë vazhdojnë të zhvillohen detajet e Modelit të Forcave të NATO-s, përfshirë shkallën dhe përbërjen e tij të saktë. Kalimi në modelin e ri është planifikuar të përfundojë më vonë në 2023.

Aleatët gjithashtu kanë rënë dakord të rrisin aftësinë e NATO-s për të përforcuar forcat e saj në lindje, duke zhvilluar më shumë pajisje të para-pozicionuara dhe rezerva armësh; më shumë aftësi të dislokuara përpara, duke përfshirë sistemet e integruara të mbrojtjes ajrore dhe raketore; komandimi dhe kontrolli i forcuar; dhe plane të përmirësuara të mbrojtjes, me forca specifike të paracaktuara për mbrojtjen e aleatëve të veçantë.

Këto forca të paracaktuara do të punojnë me forcat në vend, si forcat kombëtare të mbrojtjes vendase ashtu edhe forcat e pranisë përpara aleate dhe do të familjarizohen me terrenin lokal, objektet dhe shoqet e para-pozicionuara në mënyrë që të mund të përforcojnë aleatët e tyre edhe më shpejt.

NATO shton mbikëqyrjen në Detin e Zi

NATO ka rritur praninë e saj ushtarake në pjesën lindore të Aleancës si rezultat i drejtpërdrejtë i sjelljes së Rosisë, e cila pasqyron një model veprimesh agresive kundër fqinjëve të saj dhe komunitetit më të gjerë transatlantik. Rusia është kërcënimi më domethënës dhe i drejtpërdrejtë për sigurinë e aleatëve dhe për paqen dhe stabilitetin në zonën euro-atlantike. Prandaj aleatët ranë dakord në Samitin e NATO-s në Uells në shtator 2014 për të zbatuar Planin e Veprimit të Gatishmërisë (RAP) në mënyrë që t'i përgjigjen me shpejtësi ndryshimeve thelbësore në mjedisin e sigurisë në kufijtë e NATO-s dhe më gjerë.

Duke u bazuar në PVZH-në, aleatët morën vendime të mëtejshme në Samitin e NATO-s, të vitit 2016, në Varshavë për të forcuar qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të NATO-s dhe për të kontribuar në projektimin e stabilitetit dhe forcimin e sigurisë jashtë territorit të Aleancës. Këto vendime përfshinin krijimin e një Prezence të Përparuar të zgjeruar (eFP) në verilindje të Aleancës dhe një Prezencë të Përparuar (tFP) të përshtatur në juglindje. Së bashku, këto vendime përfaqësonin përforcimin më të madh të mbrojtjes kolektive të Aleancës në një brez. Kombinuar me forcat dhe aftësitë e kërkua për përforcim të shpejtë nga forcat pasuese, prania përpara ka rritur sigurinë e të gjithë aleatëve.

Në përputhje me vendimet e Samitit të Varshavës 2016, deri në korrik 2017 u vendosën në Estoni, Letoni, Lituani dhe Poloni katër grupe beteje shumëkombëshe. Aleatët gjithashtu rritën aktivitetin e tyre në juglindje përmes një pranie të përshtatur në tokë, në det dhe në ajër për të rritur ndërgjegjësimin e situatës, ndërveprueshmërinë dhe reagimin. Ndërsa në përgjigje të veprimeve të Rosisë në rajonin e Detit të Zi në nëntor 2018, NATO vendosi të rrisë praninë e saj në rajon për të përmirësuar më tej ndërgjegjësimin e situatës. Aleatët gjithashtu rritën mbështetjen e tyre për Gjeorgjinë dhe Ukrainën me më shumë trajnime dhe stërvitje për forcat detare dhe rojet bregdetare, si dhe vizitat në port.

Pas pushtimit të paprovokuar dhe të pajustificuar të Rosisë në Ukrainë në shkurt 2022, aleatët kanë dërguar anije, avionë dhe trupa shtesë në territorin e NATO-s në Evropën Lindore dhe Juglindore, duke përforcuar më tej qëndrimin parandalues dhe mbrojtës të Aleancës. Kjo përfshin mijëra ushtarë shtesë në grupet e betejes të NATO-s, avionë luftarake për të mbështetur misionet e policisë ajrore të NATO-s, forcat detare të forcuara në Detin Baltik dhe Mesdhe, rritjen e gatishmërisë së përgjithshme të trupave dhe për herë të parë vendosjen e elementit të gatishmërisë së Forcës së Reagimit të NATO-s në Rumani.

Në Samitin e jashtëzakonshëm të NATO-s në Bruksel, më 24 mars 2022, krerët e shteteve dhe qeverive aleate ranë dakord të krijojnë katër grupe luftarake shumëkombëshe në Bullgari, Hungari, Rumani dhe Sllovakia. Krijimi i katër grupeve të tjera beteje, së bashku me përforcimin e katër grupeve ekzistuese të betejes në verilindje, ka zgjeruar praninë përpara të Aleancës përgjatë krahut lindor të NATO-s, nga Deti Baltik në veri deri në Detin e Zi në jug, dhe efektisht dyfishoi numrin e trupave në terren. Në Samitin e NATO-s 2022 në Madrid, aleatët ranë dakord të rrisin grupet e betejes shumëkombëshe nga madhësia e batalionit në madhësinë e brigadës, ku dhe kur kërkohet. Aleatët ranë dakord gjithashtu për një model të ri të forcës së NATO-s që do të përfshijë më shumë trupa në gatishmëri të lartë dhe masa të mëtejshme për të rritur aftësinë e NATO-s për të përforcuar aleatët në lindje.

eFP e NATO-s tregon solidaritetin, vendosmërinë dhe aftësinë e Aleancës për të vepruar menjëherë në përgjigje të çdo agresioni. Stërvitet dhe trajnimet në mbështetje të pranisë së NATO-s përpara u japin forcave aleate përvojë duke punuar së bashku, duke rezultuar në gatishmëri dhe ndërveprueshmëri të shtuar. Por ndërkohë mjedisin e sigurisë në zonën euro-atlantike vazhdon të evoluojë dhe kërcënimet dhe sfidat e reja po shfaqen vazhdimisht. Aleanca përshtatet dhe planifikon në përputhje me rrethanat, dhe prania e saj përpara do të mbetet për aq kohë sa e kërkon situata e sigurisë. Ajo do të vazhdojë të sigurojë që qëndrimi i saj të mbetet i besueshëm, koherent dhe elastik. Të gjitha masat e NATO-s janë dhe do të mbeten mbrojtëse, proporcionale dhe në përputhje me angazhimet ndërkombëtare. Aleanca do të ruajë transparençën që ka karakterizuar praninë e saj përpara që nga fillimi i saj.

Gruaja, liderja e së tashmes dhe së ardhmes

Gratë kanë shërbyer në ushtri në shumë role të ndryshme në juridiksione të ndryshme gjatë historisë.

Gratë në shumë vende nuk janë më, të përjashtuara nga disa lloje të misioneve luftarake si pilotimi, mekanika dhe oficerët e këmbësorisë. Që nga viti 1914, në ushtritë perëndimore, gratë kanë shërbyer në numër më të madh dhe role më të ndryshme se më parë. Në vitet 1970, shumica e ushtrive perëndimore filluan t'i lejonin gratë të shërbenin në detyrë aktive në të gjitha degët ushtarake. Në vitin 2006, tetë vende si (Kina, Eritrea, Izraeli, Libia, Malajzia, Koreja e Veriut, Peruja dhe Tajvani) rekrutuan gratë në shërbimin ushtarak. Në vitin 2013, Norvegjia u bë vendi i parë i NATO-s që dërgoi gra, si dhe vendi i parë në botë që rekrutoi gratë me të njëjtat kushte formale si burrat.

Në vitin 2017, Suedia ndoqi shembullin dhe në vitin 2018, Holanda iu bashkua këtij formacioni (megjithëse në Holandë nuk ka rekrutim aktiv në kohë paqeje).

Që nga viti 2022, vetëm tre vende rekrutuan gra dhe burra me të njëjtat kushte formale: Norvegjia, Suedia dhe Holanda.

Disa vende të tjera kanë ligje që lejojnë rekrutimin e grave në forcat e tyre të armatosura, megjithatë me disa dallime të tilla si përjashtimet nga shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit, etj.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shtetet e Bashkuara ishin në përpjekje të përgjithshme luftarake. Çdo person duhej të kontribuonte në përpjekjet e luftës, megjithatë, kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht se të gjithë duhej të luftonin. Vendi duhej të vazhdonte të financonte trupat e tij dhe të mbështeste luftën financiarisht ndërsa ushtarët po luftonin. Për këtë qëllim, Shtetet e Bashkuara u mbështetën në organizata



I vetmi komb që vendosi trupa luftarake femra në një numër të konsiderueshëm ishte Rusia. Që nga fillimi, rekrutet femra ose iu bashkuan ushtrisë të maskuara ose pranoheshin në heshtje nga njësitë e tyre.

e një komisioni oficerësh me në krye Maria Bochkarevan.

Ato u shpërndanë para fundit të vitit. Në Luftën e mëvonshme Civile Ruse, ato luftuan si për bolshevikët (këmbësorinë) ashtu edhe për Gardën e Bardhë.

Në Serbi, disa gra individuale luajtën role kryesore ushtarake. Mjekja skoceze Elsie Ingles koordinoi një tërheqje prej rreth 8 000 trupash serbe përmes Rumanisë dhe Rusisë revolucionare, deri në Skandinavi dhe më në fund në anije transporti për në Angli.

Një grua tjetër, Milunka Saviq, u regjistrua në ushtrinë serbe në vend të vëllait të saj. Ajo luftoi gjatë gjithë luftës, duke u bërë ndoshta gruaja më e dekoruar në historinë ushtarake.

Në vitin 1918 Loretta Walsh u bë gruaja e parë që u regjistrua si grua. Një ligj i vitit 1948 i bëri gratë pjesë të përhershme të shërbimeve ushtarake. Në vitin 1976, grupi i parë i grave u pranuan në një akademi ushtarake të SHBA-së.

Përafërsisht 16% e klasës së "West Point", 2013, përbëhej nga gra. Në Luftën Civile Finlandeze të vitit 1918, më shumë se 2000 gra

luftuan në Gardën e Kuqe të Grave.

Betejë

Gjatë Luftës Civile Spanjolle, mijëra gra luftuan në njësitë luftarake dhe preparoje me gjini të përzier, ose si pjesë e milicisë.

Disa vende lejojnë ushtarët femra të shërbejnë në pozicione të caktuara të armëve luftarake.

Të tjerët i përjashtojnë ato për arsye të ndryshme, duke përfshirë kërkesat fizike dhe politikat e privatësisë.

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanada janë vendet ku u arrit niveli më i lartë i pranisë ushtarake të femrave. Kanada është shënuar si veçanërisht progresive në zbatimin e hershëm të praktikave të barazisë gjinore. Një rritje e thirrjes për mundësi të barabarta, e shoqëruar me rënien e burrave të aftë për punë, të gatshëm për të hyrë në shërbimin ushtarak, nxiti vendet të reformojnë politikat drejt përfshirjes së grave.

Me hapjen e shërbimit të nëndetësive në vitin 2000, gratë tani kishin lirinë për t'u regjistruar në çdo lloj shërbimi ushtarak.

Forca Ajrore në Shtetet e Bashkuara, më 8 korrik të vitit 1948, kishte pranuar rekrutet e para femra nëpërmjet një programi të quajtur "Gratë në Forcat Ajrore" (WAF).

WAF ishte formuar në vitin 1948, kur presidenti Truman kishte nënshkruar Aktin për integrimin e grave në Forcat e Armatosura.

Programi WAF kishte përfunduar në vitin 1976, kur gratë kishin filluar të pranoheshin në Forcat Ajrore në mënyrë të barabartë me burrat, pa ndihmën e ndonjë programi të veçantë.

Edhe Shqipëria nuk ka mbetur pas në rritjen e numrin të aderimit të grave në Forcat e Armatosura, si dhe fuqizimi dhe roli i tyre në përgjegjësi të reja dhe detyra të larta.

Ne krenohemi për gratë tona të guximshme në uniformë, për kontributin e tyre të shkëlqyer. Shqipëria ka mbështetur plotësisht rëndësinë e rolit të gruas në forcimin e paqes dhe sigurisë. Sidomos gjatë viteve të fundit, për shkak të prioritetit të lartë që i është kushtuar fuqizimit të grave dhe arritjes së barazisë gjinore, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rritjen e kuotave të grave në parlament, administratë publike, ushtri, polici dhe gjyqësor. Në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimtimit 1325, Ministria e Mbrojtjes ka përfshirë perspektivën gjinore në politikat dhe procedurat e saj të rekrutimit.



të ndryshme që merreshin me mbështetje.

Gratë iu bashkuan organizatave të tilla si Komiteti për Informim Publik për të edukuar njerëzit për luftën. Ky komitet promovoi edhe nacionalizmin. Përveç punës në komisione që kanë të bëjnë me arsimin, gratë kanë punuar në të gjitha llojet e pozitave. Shumë gra u bënë anëtare të YWCA dhe shkuan jashtë shtetit për të ndihmuar ushtarët. Kjo ishte hera e parë në histori që gratë e të gjitha klasave po punonin së bashku për të ndihmuar përpjekjet e luftës. Gratë e shtresës së lartë themeluan shumë organizata vullnetare të luftës, ndërsa gratë e klasës së mesme dhe të ulët punonin në këto organizata duke punuar si infermiere ose duke plotësuar punët e burrave.

Ndoshta më e shquara ishte, një kontingjent i kalorësisë së lehtë të vijës së parë në një regjiment kozak të komanduar nga një kolonel femër, Alexandra Kudasheva.

Zonja Kolonele, Alexandra Kudasheva ishte komandantja e një regjimenti të kalorësisë së lehtë ruse nga 1915 - 1917, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe gjithashtu gjatë Revolucionit Rus. Ky regjiment kalorësie mund të ketë qenë regjimenti i parë i integruar gjinor në historinë ruse. Ajo u shqua gjithashtu për bëmat e saj të kalërimit të qëndrueshmërisë.

Maria Bochkareva, e cila u dekorua tre herë dhe u gradua në gradën e nënoficerit të lartë. Në vitin 1917, Qeveria e Përkohshme ngriti një numër "Batalionesh të Grave", me komandën



Nevruz (Turku) Sako, komisar i Shkollës së Bashkuar, rrëfen...

Ish-skënderbegasi dhe komisar i Shkollës së Bashkuar, kolonel Nevruz (Turku) Sako, vjen në rrëfimin e jetës së ushtarakut, mes mallit të shokëve të sfidave të përbashkëta dhe kujtimeve të ditës së parë në garnizonin ushtarak, i cili do të bëhej shtëpia e tij e dytë.

Gjatë verës isha në hall se si do të bëhet për të vazhduar shkollën në shtator. Por, diku nga mesi i korrikut, në një mbërmje kur mblidheshim të gjithë në shtëpi, babai më thotë: “bëhu gati se do të shkosh në shkollë në shtator, në Tiranë, në shkollën ushtarake ‘Skënderbej’, për oficer”. Unë, nëna, vëllezërit dhe motrat mbetëm të habitur, të surprizuar dhe nuk po flisnim. Këto ishin momente disa sekonda... por mendja e njeriut është shumë e shpejtë dhe nuk e llogarit dot se sa mendime kalojnë në vetëtimë. Në këto çaste më erdhën shumë pyetje e mendime, por më kryesoret që më kanë mbetur: “Unë jam gati të shkoj në çdo shkollë, kudo që të jetë ajo, dhe çdo profil a zanat, vetëm të shkollohem!”. Në fakt, as e kisha menduar ndonjëherë shkollën ushtarake, gjithmonë ëndërroja për t’u bërë doktor dhe për të shëruar nënën se ishte e sëmurë, por edhe më pëlqente kur i shikoja me bluza të bardha e të pastra, por edhe ndonjë degë si mekanik apo inxhinier. Mendimi që më mundonte më shumë ishte se doja shkollë, që të mos harxhoja para për bursë apo studimet, që të mos shpenzoja prindërit dhe të ngarkoja të ardhurat e familjes. Pas një pauze, babai vazhdoi duke thënë: “Sot na thirri gjeneral Spiro Moisiu dhe na tha që djemtë do t’i dërgoni në shkollën ushtarake. Do t’i bëjmë oficerë të ushtrisë, sepse Komandanti i Përgjithshëm ka thënë që nuk ia dorëzojmë “të deklasuerve” ushtrinë dhe shtetin, por klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, prandaj bijtë e tyre do të bëhen oficerë!”. Pastaj vazhdoi të argumentojë pse duhet të shkoja: “Ajo është shkollë e mirë dhe me leverdi për ne, sepse nuk kërkon para për studime, nuk duhet as për ushqimin dhe as për t’u veshur, të gjitha i paguan shteti. Dhe ti mëson e siguron jetën tënde. Unë kam dhënë fjalën dhe ti do të shkosh atje”. Kështu ishte rregullit, edukata, tradita, që fjala e prindërve nuk diskutohet dhe ata as të pyesin shumë për dëshirat e tua. Kuptohet që gëzimi im ishte shumë i madh, sepse do të vazhdoja shkollën. Nuk dija gjë për shkollën ushtarake dhe për ushtrinë e oficerët, sepse as në lagje, as në fis apo të njohur nuk kishim ndonjë ushtarak. Megjithatë, atë moment më dolën para syve uniforma dhe figurat e Vlash Arapit dhe Faik Gumsës, skënderbegas me uniformë, që i kisha parë kur kishim ardhur me leje për Vitin e Ri.

Periudha e fillimit, gusht-dhjetor 1959, në “Skënderbej”

Përgatitja dhe përfytyrimi im për shkollën “Skënderbej” ishte shumë i pa përcaktuar. Isha si i çoroditur, sepse nuk dija asgjë për shkollën, për njerëzit, mësimet e jetën dhe veprimtarinë e tyre. Por e kaloja me mendimin që më ka shoqëruar gjithë jetën aktive (shkolla e karriera): “Unë do të bëj dhe do të sillem si e di unë!” dhe më tej: “Po ata që ia dalin, çfarë kanë më shumë se sa unë?”. Isha i bindur në vetvete se unë do të veproj si e gjykoj, duke parë dhe duke mësuar edhe nga të tjerët, pavarësisht ç’do mendojnë të tjerët, pse duhet të trembem e të tërhiqem, ose pse duhet të kem frikë e të hutohem, si i thonë, frika e skenës, frika apo emocionet kur del para një publiku të madh, apo njerëzve me ushnet, etj. Unë do të jem vetvetja, pa u shtirur, duke u dhënë përgjigje gjërave aq dhe ashtu siç i di dhe ato që nuk di do t’i mësoj!”. Unë isha gati për shkollën, kisha një palë pantallona doku, një këmbë dhe një bluzë, kisha dhe sandalet me rripa që shkoja në shkollë, sandale me rripa gjysmë të këputura dhe asgjë tjetër. Ishte data 15 gusht 1958. U nisa pas takuara njerëzit e familjes. Më shoqëroi nëna deri tek Dega Ushtarakë, ku na priste një makinë ushtarake “Zis”. Oficeri bëri apelën dhe ne hipëm në makinë rreth 5-6 veta nga Lushnja, të cilët nuk i njihja. Njihja vetëm Vangelj Mertzin, që ishte aty nga qyteti dhe ishin shokë të klasës së shtatë. Të tjerët vinin nga fshatrat e Lushnjës, nga Berati, Qyteti i Stalit dhe Fieri. U nis makina dhe ne shumica, rrinim në këmbë në karroceri, mbështetur në spondat që ishin të larta dhe shkonim arat, vreshtat dhe qytetet; teksa kaluam Rrogozhinën, Kavajën, Plepat te plazhi dhe nga rruga e Ndroqit, arritëm në Tiranë. Nuk kisha qenë në Tiranë (atëherë nuk kishte TV, as radio, as gazetën “Zëri i Popullit” nuk e blinin, që mund të shikonim ndonjë fotografi të Tiranës) dhe shikoja pallatet, që më dukeshin të larta (4-5 kate dhe shumë qytet i madh. Arritëm në shkollë pasdite dhe sapo u futëm në territorin e saj, pushuan bisedat dhe shikonim rreth e rrotull me habi dhe kuriozitet. Menjëherë na çuan te berberët, Hamdiu dhe Bedriu na qethën zero, dhe pastaj në dush, na dhanë rrobat, u veshëm me uniformën ushtarake dhe filluan rreshtimet. Në fjetore morëm çarçafët, rregulluan krevetët dhe filloi ushtria, orari, komandat, rresht etj... Fillimisht rrinim me grupe 2-3 e më shumë veta, sipas njohjes fillestare nga vinim dhe pasi kaluan disa ditë, filluan të shpërbëheshin grupet që u krijuan në fillim. Unë shoqërohesha me Bardhyl Mezinin, Çlirim Pulajn nga Tirana, Ilmi Fudullin (Qazimi), Myslim Pashaj, Kujtim Basha, Nebi Shkëmbi, Petrit Aliaj nga Berati- Skrapari, Patriot Aliaj, Sulo Beqiri, Feti Licaj, Selam Haskaj, Luftar Muçaj nga Vlora, Pjetër Shkrelit, Bajram Muja, Mit’hat Cufi, Pajtim Ajazi nga Shkodra, Arben Pison, Proletar Doraci, i ndjeri Vilson nga Gjirokastra, Spiro Karavella, Hasan Shabani dhe Maksut Callo nga Saranda, i ndjeri Petrit Kovaci, Llambi Angjellari nga Pogradeci, Emnor Bardhi, Gaqo Demiri, Viktor Kolaneci nga Korça, Muharrem Shehu nga Elbasani, etj. Tremujori i parë, sidomos muaji i parë, disi edhe i dyti, ishin të vështirë, kishte shumë shokë që mërziteshin dhe donin të largoheshin nga shkolla, qanin e rrinin të vetmuar. Edhe unë mërzitesha shumë, por kur mendoja për t’u larguar nga shkolla, menjëherë më dilte përpara puna në kooperativë, gjendja dhe jetesa në familje, të ardhurat që siguronim, që asnjëherë nuk kishim sa duhet, shokët që vazhdonin shkollën, pastaj vitet pa shkollë dhe gjithë ato mendime, ëndërrime e dëshira për të vazhduar me çdo kusht shkollën. Kështu që mendimin për të lënë shkollën, e kisha fiksuar që nuk do të largohem, sikur ç’të bëhej. Unë do të largohesha i fundit nëse do të ndodhte kjo gjë. Në këto kushte, unë filluam moralin me shokët që mërziteshin dhe qanin e donin të largoheshin. U jepja kurajë, se ja do të kalojë shpejt, se ne këtu jemi bashkë dhe duke i pyetur se nga ishin e ç’ njerëz kishin, si jetonin etj. Gjeja shumë argumente për t’u thënë: “Ky është rasti që ti ta ndryshosh gjendjen e familjes dhe tënden”, “. . .po ja që edhe ata të viteve të dyta e të treta si kanë ndënjur? Pse ata më të zotë se ti e se në janë?”, “. . .po kur të shkosh në shtëpi gjithë



fshati, apo lagja do të tallen me ty se shkove në shkollë dhe nuk ishe i zoti të qëndroje”, etj. Megjithatë, disa edhe u larguan. Por shumica filluan të mësonin dhe përshtaten me regjimin e jetesës dhe veprimeve në shkollë, që për të qenë të sinqertë është regjim i vështirë, madje shumë i vështirë për moshën të njoma e të pamësura (këto të krahasuara me shkollat e tjera dhe mjediset familjare). Pasi kaluan muajt e parë dhe filluan të shkonin me leje e liridalje, ata që ishin afër Tiranës, dhe sidomos për Vitin e Ri që kishim pushime, (me përjashtim të Tropojës e Kukësit, e ndonjë tjetër që rrugët ishin të bllokua nga dëbora, të gjithë të tjerët shkuan pranë familjeve), sikur u ambientuan mirë. Tremujori i parë u mbyll dhe secili mori edhe vlerësimin e mësimëve. Ata që nuk kaluan klasën dhe mbetën në tre e më shumë lëndë i larguan nga shkolla dhe shkuan në shtëpi. Unë isha në grupin e më të mirëve me mësimet, por edhe me disiplinën e aktivitetet që zhvilloheshin atje. Ishin bërë zgjedhjet në rini dhe unë isha zgjedhur sekretar i rinisë. Ngjarja më e veçantë e kësaj periudhe, ishte vizita në Krujë, i një grupi skënderbegasish nga çdo vit mësimor (ata me rezultate më të larta). Nga viti i parë, u caktova unë, mbaj mend edhe Pajtim Ajazin, Vasil Nanushin, Vladimir Tira (kaq më kujtohen nga fotografia me Enver Hoxhën). Nga vitet e mëparshme, Bashkim Kozelin, ndërsa të tjerët nuk i kishim njohur akoma. Kjo vizitë bëhej në kuadrin e festave të Nëntorit, 15-vjetori i Çlirimit të Atdheut, ku erdhën Enver Hoxha dhe disa anëtarë të tjerë të Byrosë Politike, si Mehmet Shehu, Beqir Balluku, Petrit Dume, Manush Myftiu etj. Pasi pamë Kalanë e Krujës, Mehmeti i thotë Enverit: “Shoku Enver bëjmë një fotografi me këta sternipat të Skënderbeut”, dhe Enveri u tregua i gatshëm dhe na ftoi të gjithëve për një fotografi. Kjo fotografi (është në dy variante) është rrethuar me vonë kur dolën “grupet armiqësore” dhe po ta shohësh fotografia ime është retusuar. Ne krahum tim të majtë ishte Bashkim Kozeli, që e kanë hequr, ai nuk ishte “armik”, por pse? Nuk e di pse, por prapa ka qenë edhe Manush Myftiu, në një foto me ne dhe më vonë është hequr?! Në dhjetor para Vitit të Ri, dilnin dhe rezultatet e semestrit të parë dhe të gjithë shkuan me pushime. Ne, grupi nga Lushnja, Fieri dhe Berati, po edhe Vlora e më tej, shkonim me tren deri në Rrogozhinë dhe pastaj me makina të rastit në karroceri të “Gazit”, “Zisit”, apo të “Skodës”, por që nuk na merrnin lekë shofertë sepse ishim ushtarë. Gjatë vitit të parë, mua më mori me ekipin e gjimnastikës, mësuesi i fizikuturës, mjeshtër i merituar i sportit dhe kampion kombëtar për gjimnastikën në vegla, Bujar Bujari. Bënim stërvitje pasditeve në kohën e kulturës masive disa herë në javë, në palestrën e shkollës, ku kishim të gjitha veglat. Me mua morën edhe Mëhill Mirashin dhe Arben Pison. Kjo vazhdoi deri në fund të vitit të parë. Atë vit, u praktikua që viti i fundit i shkollës, të shkonin një muaj në repartet ushtarake, në praktikë, në rolin e ushtarit. Profesori më mori edhe mua me ekipin e gjimnastikës me skënderbegasit që shkuan në praktikë, në Durrës tek Plepat. Në atë vit mbaj mend që Divid Ibrahim, Andrea Rrenza, Arqivadih Dede, Ilija Kongo dhe Nasi Gjergo, ishin ekipi i gjimnastikës të shkollës dhe të rinjtë e “Partizanit”. Aty ndenja rreth dy javë a më shumë dhe u largova me lejen e profesorit dhe nuk u ktheva deri në fund të pushimeve. Pushime bënim rreth dy muaj gjatë të cilave unë punoja në fermën bujqësore “29 Nëntori” të Lushnjës dhe, vetëm një 15-ditësh bëja pushim. Nga tre 15-ditësha pune, merrja me vete lekët e pesëmbëdhjetëditëshit të fundit, të tjerët ia dorëzoja babait.

Me fillimin e vitit të dytë unë filluam me futbollin, u largova nga gjimnastika. Nga skuadra e futbollit dua të përmend disa gjëra. Filluam me skuadrën e futbollit të shkollës, që në fakt ishte skuadra e të rinjtë të “Partizanit”. Stërvitjen e bënim me mjeshtër të sportit Fadil Voglin, i cili kishte qenë lojtar titullar i “Partizanit” dhe tani merrte me stërvitjen e të rinjtë. Fadili e kombinonte stërvitjen fizike e atletike me lojën me top, kishte njohuri dhe përvojë, sepse i kishte stërvitur mjeshtri i

madh Loro Borici.

Ndeshjen e parë të kampionatit e kemi zhvilluar me “Korabin” e Peshkopisë. Pas një viti largohet si trajner dhe e zëvendëson mjeshtri i sportit, Sllave Llambi. Sllave Llambi ishte më i vjetër, ai kishte qenë me “Partizanin” dhe me Kombëtares pas viteve 1945. Para 1945, ai kishte luajtur edhe në Itali. Ishte shumë praktik, fliste thjeshtë dhe të mësonte shumë gjëra që të duheshin në lojë. Kombinonte me mjeshtri teorinë me praktikën, duke u përqendruar më shumë në skema të thjeshta e konkrete. Më vonë, na bënte stërvitje Simon Deda, të cilin e kisha parë edhe kur luante me “Partizanin” e kombëtaren, sulmues i majtë. Lëvizte shpejt gjatë vijës anësore dhe gjithmonë e përfundonte me kros të topit në zonën e gjashtëmbëdhjetës, ashtu siç bënte edhe Kolec Kraja, sulmuesi i djathtë. Në Shkollën e Bashkuar, trajner kemi pasur edhe mjeshtër Refik Resmja, gjysmë sulmues i majtë, i “Partizanit” dhe Kombëtares. Ai kishte përdorim të mirë topit dhe nga anësorja, futej në qendër ku me rrotullim në vend gjuante portën me të majtën, ose priste krosimin nga anët dhe gjuante me rafishatë, që në të shumtën e herës bënte gol. Nëse do të bëja ndonjë dallim mes trajnerëve do të thosha: Sllava ishte shumë konkret, me fjalë pak dhe i saktë, të tregonte me shembuj dhe raste ku gabohet. Simoni ishte shumë energjik, kishte njohuri teorike shumë, mbante shënime për çdo praktikë dhe sidomos në ndeshje. Në stërvitje bënte shumë përgatitje atletike dhe fizike, rreth 70% të kohës, dhe në fund të jepte topin kur ishe “telikosur”. Ndryshonte stërvitja e Simonit, sepse kur ne bënim ndeshje, nuk lodheshim deri sa mbaronte sfida, edhe sikur të kishte akoma lojë, ne luanim pa e ndër. Kjo bënte që edhe në qoftë se ndonjë skuadër na bënte gola, apo na mundte në pjesën e parë, ne duke qenë të freskët dhe plot energji në pjesën e dytë, e mundnim kundërshtarin me lojë dhe me gola. Ndërsa Refiku na bënte 20-30% lëvizje të lehta, pastaj na praktikonte me topin dhe lojë deri në fund të stërvitjes. Kjo bënte që në ndeshje ne të fitonim në pjesën e parë dhe në të dytën nuk kishim me fuqi të luanim. Shumë herë ne e bënim stërvitjen të klubi “Partizan”, në Laprakë dhe luanim me skuadrën e parë. Edhe kur ishim me rezervat e “Partizanit”, po e njëjta gjë. Ndeshjet më të forta bëheshin kur luanim me skuadrat e të rinjtë të “17 Nëntorit” dhe “Dinamon”. “Partizani”, lojtarët e mirë të skuadrave të të rinjve i merrte ushtarë dhe kështu plotësohej skuadra e rezervave që një nga një futeshin në skuadrën e parë. Kështu ndodhi me Mexhit Haxhiun e Vlorës, Bukovikun, Xuxin e Tiranës, etj. Shpesh stërvitjet i bënim tek fusha e “Partizanit” në Laprakë dhe këto koordinoheshin që të zhvillonim ndeshje stërvitore me skuadrën e parë të Partizanit, ose ndeshje kontrolli siç quheshin. Dhe këto i drejtoje mjeshtri i madh Loro Borici, ashtu si edhe sot, të bënte të njohur me shumë sportdashës, kështu që unë dhe gjithë ata që luanim me skuadrën e shkollës dhe jo vetëm, njiheshin nga e gjithë shkolla, përfshi edhe pedagogët dhe oficerët që në mësim nuk kishin lidhje me ne. Me skuadrën e futbollit kam luajtur në Peshkopi, Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë edhe në Lushnjë, me rezervat e Partizanit. Në marshimet që bëheshin në fundjavë, në fushime dimërore, në aksionet kombëtare në ndihmë të ekonomisë, si në bujqësi për korrje e mbledhje të misrit, drithërove, në hapjen e rrugëve kombëtare në malësi, në hekurudhë etj., që ka bërë shkolla, unë dhe shokët pjesëmarrës në skuadrat e “Partizanit”, nuk kemi shkuar, sepse kishim ndeshjet dhe aktivitetet sipas kalendarit sportiv vjetor. Edhe në verë kur mbaronim mësimet në Shkollën “Skënderbej” bëhej kampionati ushtarak, ku merrim pjesë unë, Selam Haskaj, Viktor Seiti, Fiqiri Doda nga futbollit; Patriot Aliaj, Gaqo Demiri, Petrit Zotaj, Sulo Beqiri e Luftar Muço, në basketboll; Arben Pison, Mëhill Mirashi, Petrit Bebeci, Roland Paluka dhe Bilal Koci në gjimnastikë; Ali Cena, Agim Guma dhe Pavlo Vangeli në voleyboll etj.. Të gjithëve na inkuadronin në skuadrat e Shkollës së Bashkuar si pjesëmarrës në kampionatin ushtarak. Shkolla e Bashkuar ishte ndërm ekipet pretendente për të fituar titullin kampion dhe në shumë sporte ajo e fitonte pa diskutim.

Për katër vitet e shkollës, ka shumë për të shkruar dhe unë nuk do të ndalem në hollësi të jetës së përditshme, por do të shkruaj shumë shkurt, duke paraqitur mendimet dhe vlerësimet e mia, ç’më kujtohet nga ajo kohë tani në moshën 70 e ca vjeçare. Shkolla “Skënderbej”, për mua, ishte një shkollë e veçantë që qëndronte mbi të gjitha shkollat e tjera të Shqipërisë, për gjithë periudhën që ajo ekzistoi në vendin tonë deri sa banda e çetnikëve, e politikanëve antikombëtarë, hajdutë dhe servilë e agentë të të huajve që kanë marrë për detyrë ta shkatërronin Shqipërinë dhe ushtrinë e saj, e mbyllën shkollën “Skënderbej”. Megjithatë, përsëri përgatiten nxënës dhe studentët për oficerë, por jo në Shqipëri. Si i thonë një fjalë që ata “mbyllën fushën se lojtarët i shpërdanë nëpër botë”. Për mua, të rinjtë që do të bëhen oficerë, më parë duhet të bëhen oficerë shqiptarë, ushtarakë shqiptarë dhe këtë drejtim e marrin këtu në shkollën e vendit të tyre me mësues, edukatorë dhe oficerë shqiptarë, me traditën shqiptare të shkollave ushtarake, të ushtrisë shqiptare, pastaj le të shkojnë në çdo vend të botës për të mësuar dhe specializuar.

Shkolla “Skënderbej” ishte e veçantë, sepse ajo dallonte në të gjithë parametrat shkencorë, pedagogjikë dhe edukativë të institucioneve arsimore të Shqipërisë. Disa nga çështjet që unë do të trajtoj këtu janë të njëjta si në të gjitha shkollat e mesme të përgjithshme të Republikës të asaj kohe dhe unë do të ndalem me theks në disa prej tyre që i kam vlerësuar dhe gjykurat më mirat e kohës.

Programet dhe planet mësimore të shkollës kishin nivel të lartë shkencor. Ato bëheshin me grupe studimi, me mësues dhe specialistë me përvojë dhe diskutoheshin me masën e mësuesve. Baza e programeve mësimore ishte e zbërthyer në elementë përbërës thelbësorë të shkencës përkatëse të çdo lënde mësimore. Nxënësit i jepeshin ato tema dhe probleme

